



*GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA*



531/2096

08. 09. 2016

Aj.nr.

Datë. 2016

Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016 jep këtë:

MENDIM JURIDIK

Në lëndët sipas padisë së Administratës Tatimore të Kosovës, kundër personave juridik apo fizik si të paditur, për shkak të mos pagesës së borxhit tatimor, kur kërkohet vërtetimi i bazës juridike dhe lartësisë së tatimit (ligjshmëria e aktvendimit lidhur me tatimin), kompetent për të vendosur është Divizioni fiskal i Departamentit për çështje administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa në lëndët, në të cilat kërkohet përmbarimi i aktit administrativ të plotfuqishëm lidhur me tatimin e caktuar, është kompetent për të vendosur Departamenti i përgjithshëm i Gjykatës Themelore, në procedurë përmbarimore.

Arsyjetimi

Gjykata Themelore në Prishtinë, me parashtresën GJA.nr.604/2016 datë 07.04.2016, nga Gjykata Supreme e Kosovës, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik, se në lëndët sipas padisë së Administratës Tatimore të Kosovës, kundër personave juridik apo fizik si të paditur, për shkak të mos pagesës së borxhit tatimor, cili departament i gjykatës është kompetent për të vendosur, Departamenti për çështje administrative, apo Divizioni fiskal i këtij departamenti, apo ndonjë departament tjetër i kësaj gjykate.

Në lëndët sipas padisë së Administratës Tatimore të Kosovës, kundër personave juridik apo fizik si të paditur, për shkak të mos pagesës së borxhit tatimor, kur kërkohet vërtetimi i bazës

juridike dhe lartësisë së tatimit (*ligjshmëria e aktvendimit lidhur me tatimin*), kompetent për të vendosur është Divizioni Fiskal që vepron në kuadër të Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në bazë të nenit 81.B.1 të ligjit Nr.04/L-102 (*i shpallur në Gazetën zyrtare të R. së Kosovës nr. 13 maj 2012, në fuqi prej datës 15 qershor 2012*). Në këtë dispozitë juridike parashihet që Divizioni Fiskal, i themeluar në kuptim të nenit 1.46 të këtij ligji në kuadër të Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjeter të caktuar nga legjislacioni në fuqi. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni (81.B), parashihet se juridiksoni i ankesave të Divisionit Fiskal mbulon tatimet dhe detyrimet në vijim: tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat e korporatave, ligjin e TVSH-së, detyrimet doganore, detyrimet e akcizës, tatimi mbi pronën e paluajtshme, dhe çdo tatim apo kontribut tjeter të aplikuar në Kosovë. Në kuptim të pikës 3 të këtij neni, kundër vendimeve të Divisionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit.

Mirëpo, në lëndët e ngjashme, edhe pse sipas nenit 32, 33, 34, 35 dhe dispozitave tjera ligjore të Ligjit bazik mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, Administrata Tatimore disponon me një mori mundësish që të arkëtoi dhe të mbledh tatimet e papaguara, por që janë bërë të detyrueshme dhe të pagueshme, Gjykatës Supreme mendon se mund të kërkohet përmbarimi i aktvendimit të plotfuqishëm lidhur me tatimin, detyrimet doganore apo lidhur me çdo tatim ose kontribut tjeter të aplikuar në Kosovë, dhe përmbarimi i një aktvendimi të tillë bëhet nga ana e Departamentit të Përgjithshëm –Civil, në procedurë përmbarimore, sipas dispozitave të Ligjit për procedurë përmbarimore. Një aktvendim i tillë i plotfuqishëm paraqet akt administrativ të plotfuqishëm, i cili në kuptim të nenit 22.1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, paraqet dokument përmbarues, kështu që përmbarimi i këtij akti si dokument përmbarues, në kuptim të nenit 16.1 të Ligjit për Gjykatat në Kosovë, bie në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, dhe ky përmbarim bëhet në procedurë përmbarimore, sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

(Mëndim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016)